



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 33814 Prot.

Vlorë, më 11.02.2020

**VENDIM**

**Nr. 62, datë 11.02.2020**

**PËR**

**KRITERET DHE STANDARDET PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË  
DISERTACIONEVE TË PËRDORURA PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE NË UV**

Në zbatim të VKM nr 99, dt. 5.02.2020 "Për disa ndryshime në VKM nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradës shkencore", të Urdhrit nr.8, datë 14.01.2020 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procesin zgjedhor për autoritet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", të vendimit të SA Nr. 59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e rregulloreve për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", dhe Rregulloreve së etikës së kërkimit dhe publikimit shkencor në UV, Senati Akademik në mbledhjen e datës 11.02.2020

**VENDOSI:**

1. Respektimin e kriterëve dhe standardeve për kontrollin antiplagjiaturë, si më poshtë:

a) **Kriteret teknike** (dixhitale) të përcaktuara në Manualin e përdorimit të *Software*-it të ofruar nga MASR.

b) Vërtetësinë dhe autenticitetin ligjor e shkencor të tekstit origjinal të disertacionit si **kriter dokumentar**:

2. Nuk konsiderohen/vlerësohen si pjesë "të ngjashme", paragrafë të tillë si më poshtë:

a) citime të çfarëdollojshme sipas gjithë manualeve përkatëse propozuar dhe aplikuar nga shkolla të ndryshme të shkrimit akademik, në trup të tekstit autorial apo në çdo pjesë tjetër të faqes;

b) perifrime të adresuara në autorë, rryma apo shkolla mendimi teorik, praktik e shkencor, vendas e botëror, por jo të futura në thonjëza;

c) *footnote*;

ç) përdorimi i pjesëve të shkruara nga autori në botime të tjera paraardhëse ("self-plagiarism");



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

d) çdo rezultat "ngjashmërie" që vjen nga: mosverifikimi i vitit të publikimit të një artikulli/dokumenti, mënyrës jo korrekte të përkthimit, pamundësisë teknike të verifikimit të dokumenteve të skanuara, pamundësisë teknike të verifikimit total të tekstit të "doktoraturës" apo publikimeve të tjera, pamundësisë së verifikimeve të tabelave dhe grafikëve, si dhe nga çdo arsye tjetër teknike dixhitale që nuk lidhet me qëllimshërinë për plagjiaturë të autorit;

e) çdo pjesë tjetër brenda tekstit autorial apo teksteve të cituara që evokon një të dhënë tjetër me karakter universal historik, shkencor apo teorik të gjithëpranuar në çdo kohë nga gjithë komuniteti shkencor i një fushe të caktuar;

ë) çdo paragraf tjetër që autori argumenton me fakte se nuk është ngjashmëri, por pjesë logjike e arsyetimit të tij shkencor në rastin e publikimit përkatës;

f) pjesët hyrëse, (introduktet), prologët, epilogët, biobibliografia, bibliografi apo burime të tjera që janë përdorur nga autori në funksion të shtrimit dhe vërtetimit të hipotezës/tezave shkencore dhe kthimit të saj/tyre në kontribut origjinal autorial shkencor.

3. Procesi i kontrollit antiplagjiaturë të respektojë standardin e përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me Ligjin nr.120/2014 "PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE".

6. Konsiderohen studim plagjiaturë ato disertacione të përdorura për marrjen e gradës shkencore, tek të cilat "ngjashmëria" e kalon kufirin mbi 25%, në raport me pjesën autoriale origjinale të disertantit.

7. Ky vendim shtohet si një nen i veçantë në Rregulloren e etikës së kërkimit shkencor dhe publikimit në UV", në formën e mëposhtme:

neni x


1. Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, UV ndjek dhe respekton kriteret dhe standardet e mëposhtme:

a) **Kriteret teknike** (dixhitale) të përcaktuara në Manualin e përdorimit të *Software*-it të ofruar nga MASR.

b) Vërtetësinë dhe autenticitetin ligjor e shkencor të tekstit origjinal të disertacionit si **kriter dokumentar**:

2. Nuk konsiderohen/vlerësohen si pjesë "të ngjashme", paragrafë të tillë si më poshtë:

a) citime të çfarëdollojshme sipas gjithë manualeve përkatëse propozuar dhe aplikuar nga shkolla të ndryshme të shkrimit akademik, në trup të tekstit autorial apo në çdo pjesë tjetër të faqes;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

b) perifrime të adresuara në autorë, rryma apo shkolla mendimi teorik, praktik e shkencor, vendas e botëror, por jo të futura në thonjëza;

c) *footnote*;

ç) përdorimi i pjesëve të shkruara nga autori në botime të tjera paraardhëse ("self-plagiarism");

d) çdo rezultat "ngjashmërie" që vjen nga: mosverifikimi i vitit të publikimit të një artikulli/dokumenti, mënyrës jo korrekte të përkthimit, pamundësisë teknike të verifikimit të dokumenteve të skanuara, pamundësisë teknike të verifikimit total të tekstit të "doktoraturës" apo publikimeve të tjera, pamundësisë së verifikimeve të tabelave dhe grafikëve, si dhe nga çdo arsye tjetër teknike dixhitale që nuk lidhet me qëllimshërinë për plagjiaturë të autorit;

e) çdo pjesë tjetër brenda tekstit autorial apo teksteve të cituara që evokon një të dhënë tjetër me karakter universal historik, shkencor apo teorik të gjithëpranuar në çdo kohë nga gjithë komuniteti shkencor i një fushe të caktuar;

ë) çdo paragraf tjetër që autori argumenton me fakte se nuk është ngjashmëri, por pjesë logjike e arsyetimit të tij shkencor në rastin e publikimit përkatës;

f) pjesët hyrëse, (introduktet), prologët, epilogët, biobibliografia, bibliografi apo burime të tjera që janë përdorur nga autori në funksion të shtrimit dhe vërtetimit të hipotezës/tezave shkencore dhe kthimit të saj/tyre në kontribut origjinal autorial shkencor.

3. Procesi i kontrollit antiplagjiaturë të respektojë standardin e përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me Ligjin nr.120/2014 "PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE".

6. Konsiderohen studim plagjiaturë ato disertacione të përdorura për marrjen e gradës shkencore, tek të cilat "ngjashmëria" e kalon kufirin mbi 25%, në raport me pjesën aitoriale origjinale të disertantit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

